FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 68

Tiranë – E premte, 6 maj 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 35/2022, datë 14.4.2022	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 2, datë 2.3.2022, "Për një shtesë në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, "Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë" ,të ndryshuar.....	8587
Dekret i Presidentit nr. 13589, datë 28.4.2022	Për shpallje ligji.....	8587
Rezolutë e Kuvendit datë 28.4.2022	Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2021.....	8587
Rezolutë e Kuvendit datë 28.4.2022	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2021.....	8589
Rezolutë e Kuvendit datë 28.4.2022	Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri për vitin 2021.....	8591
Dekret i Presidentit nr. 13597, datë 29.4.2022	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8592
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 282, datë 29.4.2022	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Mark Marku.....	8592
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 9, datë 27.4.2022	Për kriteret, procedurat dhe afatet për shpalljen e thirrjes dhe për dokumentacionin e nevojshëm për aplikim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, për financimin/bashkëfinancimin e projekteve për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe sportive.....	8592
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 244, datë 14.4.2022	Për përcaktimin e kritereve për tregtimin me shumicë apo pakicë të pajisjeve mjekësore nëpërmjet internetit.....	8597
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 154/1, datë 29.4.2022	Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla.....	8598

Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 272, datë 26.4.2022	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 374, datë 30.8.2021, "Për hyrjen e personave në Republikën e Shqipërisë nga të gjitha pikat kufitare"...	8599
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 273, datë 26.4.2022	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 351, datë 29.5.2020, "Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së COVID-19", të ndryshuar.....	8599
Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 104, datë 6.4.2022	Autorizim i Ndihmës Shtetërore "Ndihmë me karakter social për pasagjerët në fluturimet ajrore".....	8599
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Meleq Kaptelli.....	8603

LIGJ
Nr. 35/2022

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 2, DATË 2.3.2022, "PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR. 8952, DATË 10.10.2002, "PËR LETËRNJOFTIMIN ELEKTRONIK TË SHTETASVE SHQIPTARË" ,TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 2, datë 2.3.2022, "Për një shtesë në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, "Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë", të ndryshuar.

Miratuar në datën 14.4.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13589, datë 28.4.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET
Nr. 13589, datë 28.4.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 35/2022, "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 2, datë 2.3.2022, 'Për një shtesë në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, 'Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë', të ndryshuar".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË PËR VITIN 2021

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur Entin Rregullator të Energjisë si rregullatorin e vetëm dhe të pavarur për mbikëqyrjen e funksionimit të tregut të energjisë elektrike e të gazit natyror, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

Duke theksuar se situata e krizës globale energjetike ka çuar në një rritje të çmimit të energjisë në tregun ndërkombëtar në nivele si kurrë më parë, me pasoja të drejtpërdrejta në buxhetin e shtetit;

Duke vlerësuar trendin pozitiv të uljes së nivelit të humbjeve të energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes, i cili vijon të ketë një rënie nga viti në vit, për vitin 2021 ato arritën në nivelin 20.62%, duke shënuar një ulje të mëtejshme krahasuar me nivelin prej 21.48% të vitit 2020, ndërkohë niveli total i arkëtimeve për vitin 2021 arriti shifrat 97.4% krahasuar me 95.8% që ishte në vitin 2020, ky tregues në vitet e fundit është konsoliduar në nivelin mbi 95%;

Duke theksuar se, megjithëse me vonesë, u arrit përzgjedhja e Ofruesit të Shërbimit të operimit të bursës, një hap i rëndësishëm ky për funksionimin dhe futjen në operim të Bursës Shqiptare të energjisë elektrike ALPEX;

Duke theksuar se klientët buxhetorë dhe jobuxhetorë vazhdojnë të jenë problem për sa u takon pagesave të faturave të energjisë elektrike, duke akumuluar një borxh për shoqërinë FSHU sh.a. dhe duke krijuar vështirësi financiare për këtë të fundit;

Shqyrtoi veprimtarinë e ERE-s për vitin 2021 dhe vlerëson:

- Punën e bërë për ndarjen funksionale të OSHEE sh.a., si hap i rëndësishëm me ndikim të drejtpërdrejtë në liberalizimin e tregut të energjisë elektrike dhe hapjen e mëtejshme të tij.

- ERE ka punuar për nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit me ZRRE-në (Rregullatori i Kosovës) për njohjen reciproke të licencave në veprimtarinë e tregtimit dhe furnizimit mes Shqipërisë dhe Kosovës, i cili i

hap rrugën operimit të një tregu të përbashkët, si dhe ul kostot administrative dhe financiare të të licencuarve në të dyja vendet për të operuar në të dyja tregjet.

- Punën e bërë për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve, zvogëlimin e afateve të trajtimit të ankesave, si dhe komunikimin dhe përpjekjet e vazhdueshme për të informuar konsumatorin për të drejtat dhe detyrimet ndaj operatorëve të licencuar, por edhe për të drejtat e tyre në raport me ERE-n.

- Punën për bërjen funksionale të Tregut të Balancimit të Energjisë Elektrike, e kërkuar dhe e mbështetur edhe nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në Vjenë, si një hap i rëndësishëm në reformën e sektorit të energjisë në vendin tonë, veçanërisht për liberalizimin e tregut të energjisë.

- Punën e bërë për vlerësimin e kuadrit rregullator dhe ligjor, përfshirë edhe tarifimin e shërbimeve që vijnë nga përdorimi i teknologjive të reja, siç është rasti i stacioneve të ngarkimit të automjeteve elektrike.

- Punën e bërë për informimin dhe sensibilizimin e konsumatorit përmes nënshkrimit të memorandumeve të bashkëpunimit me disa universitete, përgatitjes së broshurave informative për konsumatorin, publikimit të tyre në faqen zyrtare të ERE-s dhe rrjetet sociale, prezantimet pranë shoqatave të konsumatorit, si dhe vënien në funksion të një numrin telefonik të dedikuar për konsumatorin.

Kuvendi i Shqipërisë, për vitin 2022, rekomandon që ERE të angazhohet veçanërisht në këto aspekte të veprimtarisë së saj:

1. Në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe aktorët e tjerë në fushën e energjisë të luajë një rol aktiv në hartimin e një plani konkret për të bërë të mundur lehtësimin e barrierave, promovimin, si dhe incentivimin e impianteve të vetëprodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme (veçanërisht nga dielli dhe era), si për bizneset e mëdha prodhuese, që kanë një konsum energjie më të lartë, ashtu edhe për familjarët. Investimi në impiante të vetëprodhimit të energjisë nga burime te rinovueshme, duke pasur parasysh edhe situatën dhe zhvillimet më të fundit në tregun global të energjisë, ndikon nga njëra anë në uljen e shpenzimeve të energjisë për bizneset prodhuese dhe familjarët dhe nga ana tjetër në uljen e konsumit të energjisë nga rrjeti dhe diversifikimin e prodhimit të energjisë.

2. Duke pasur parasysh çmimet e larta të energjisë dhe zhvillimet më të fundit në tregun global të energjisë, në bashkëpunim me të gjithë aktorët në këtë fushë, të japë kontributin e saj dhe ekspertizën teknike për të bërë të mundur forcimin e mekanizmave mbështetës për konsumatorët në nevojë, si dhe ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor.

3. Të vijojë intensivisht bashkëpunimin me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për hartimin sa më parë të metodologjisë së përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga vetëprodhuesit, si dhe të luajë një rol proaktiv dhe të bashkëpunojë me të gjithë aktorët për zgjidhjen e problematikave të ndryshme, që lindin nga instalimi i burimeve të vogla të rinovueshme, si për shembull problemi i mënyrës së trajtimit të netimit nga ana e OSSH etj.

4. Të kërkojë impenjim maksimal nga të gjithë aktorët për të bërë të mundur që brenda vitit 2022 operimi i bursës të jetë funksional. Funksionimi i bursës ka ndikim të drejtpërdrejtë në bashkimin e tregut të energjisë elektrike midis Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe në lehtësimin e bashkimit me tregje të tjera të vendeve fqinje në përputhje me rregulloret e tregut të energjisë elektrike të BE-së dhe modelin e synuar evropian.

5. Të vijojë mbështetjen me ekspertizën teknike për të bërë të mundur ndërtimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, si një projekt me rëndësi për vendin në drejtim të rritjes së prodhimit të energjisë dhe diversifikimit të burimeve të prodhimit, si dhe të bëjë propozime konkrete në funksion të mundësive të reja të krijuara për zhvillimin dhe shfrytëzimin e tregut të gazit. Fillimi nga puna i gazsjellësit TAP duhet parë me prioritet nga ERE si një mundësi që e bën akoma më të domosdoshëm ndërtimin e këtij rrjeti për rritjen e prodhimit të energjisë përmes shfrytëzimit të gazit.

6. Në faqen zyrtare në internet duhet që linku / grafika "Bëj një ankesë" dhe numri i gjelbër në dispozicion të qytetarëve/konsumatorëve të jetë në faqen kryesore dhe lehtësisht i aksesueshëm,

mbrojtja e konsumatorit është një ndër objektivat kryesorë të ERE-s.

7. Gjatë vitit 2022 të miratojë dhe të fillojë zbatimin e Rregullores për Masat e të Licencuarve në Aktivitetin e Furnizimit për Arritjen e Treguesve të Matjes dhe Vlerësimit nga ERE të Performancës së Shërbimit ndaj klientit si një hap i rëndësishëm që ndikon në ofrimin e një shërbimi cilësor dhe me standarde për konsumatorin.

8. Të vijojë të ndjekë dhe të monitorojë me rigorozitet problematikat që kanë lidhje me mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve të energjisë elektrike, në mënyrë të veçantë zbatimin e detyrave që rrjedhin për FSHU sh.a., në përputhje me vendimin e Bordit të ERE-s "Mbi rishikimin e planit të masave për Operatorin e Shpërndarjes të Energjisë Elektrike "OSHEE sh.a.", për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike".

9. Në bashkëpunim me Agjencinë e Eficiencës dhe duke iu referuar edhe praktikave më të mira ndërkombëtare të punojë për sensibilizimin e konsumatorit për përdorimin eficient të energjisë elektrike, çka përkthehet në kursim energjie dhe më pak kosto për vetë konsumatorin.

10. Të marrë masat e nevojshme për realizimin dhe implementimin e platformës përmes së cilës të licencuarit në veprimtarinë e furnizimit, që do ta ushtrojnë këtë aktivitet për furnizimin e klientëve në treg të lirë, do t'iu mundësohet të hedhin të dhëna në kohë reale, në lidhje me çmimin e ofruar për furnizimin me energji elektrike në treg të lirë.

11. Të vijojë të kërkojë mundësinë e instalimit gradual të matësve inteligjentë, bazuar në një analizë kosto-përfitim dhe të mbulimit me rrjetin e telekomunikacionit, pasi veç të tjerash përmirëson cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorit, duke evituar problematikat e mbifaturimit dhe ankesat e konsumatorëve. Faktet tregojnë se edhe gjatë vitit 2021 ankesat me objekt "mbifaturim të energjisë elektrike" janë rritur krahasuar me një vit më parë duke zënë vend kryesor në totalin e ankesave të regjistruara në ERE.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 28.4.2022.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE PËR VITIN 2021

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke vlerësuar rolin e institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në zbatimin e drejtë dhe të paanshëm të mbikëqyrjes ligjore për konsolidimin e standardeve në ushtrimin e të drejtave të njeriut;

- Duke vlerësuar kontributin e institucionit në procesin e integrimit evropian të vendit nëpërmjet zbatimit me sukses të Projektit të Binjakëzimit "Ndërtimi i institucioneve për harmonizimin me *acquis* të BE-së për të përmbushur kriteret ekonomike lidhur me mbrojtjen e të dhënave", si dhe në modernizimin e kuadrit ligjor për të drejtën e informimit;

- Duke vlerësuar veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit në zhvillimin me përgjegjshmëri të hetimeve administrative *ex-officio,* në lidhje me rastin e cenimit dhe përhapjes së të dhënave personale;

- Duke vlerësuar zgjedhjen e Zyrës së Komisionerit në Komitetin Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC), si një mundësi për të nxitur autoritetet publike shqiptare në konsiderimin e transparencës si faktor pozitiv në komunikimin me publikun si mekanizëm për të luftuar korrupsionin;

Shqyrtoi veprimtarinë e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2021 dhe konstaton, se:

- Ka realizuar plotësisht rekomandimet e adresuara në rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si edhe ato të adresuara nga raporti i progresit për Shqipërinë të Bashkimit Evropian për vitin 2021.

- Ka dhënë kontribut parësor në hartimin e projektligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale" të përafruar me *acquis* të BE-së dhe projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119, datë 14.9.2014, 'Për të drejtën e informimit'".

- Ka konsoliduar procesin e shqyrtimit administrativ të ankesave për dhënien e informa-

cionit/dokumentacionit me karakter publik, aspekt i veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit, e vlerësuar edhe nga partnerë ndërkombëtarë (SIGMA/ OECD).

- Ka kryer hetime administrative me fokus monitorimin e programit të transparencës së kategorive të ndryshme të autoriteteve publike, si dhe ka dalë me vendimmarrje konkrete për zbatimin e legjislacionit në këtë fushë.

- Ka kontribuuar në shtimin e numrit të autoriteteve publike që kanë instaluar Regjistrin Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit në portalin pyetshtetin.al (REKPDI) dhe Sistemin e Menaxhimit të Aplikimit në portalin unik qeveritar *e-Albania* (AMS) për trajtimin e kërkesave/ankesave *online* nëpërmjet tyre.

- Ka kryer një veprimtari të gjerë e komplekse në kuadër të hetimeve administrative për rastet e përhapjes së të dhënave personale, duke nxitur marrjen e masave konkrete e të shpejta për garantimin e plotë të të drejtave të qytetarëve.

- Ka kryer monitorimin dhe mbikëqyrjen e kontrolluesve në sektorët e shëndetësisë, arsimit dhe marketingut të drejtpërdrejtë, të cilët në veprimtarinë e tyre përpunojnë sasi të mëdha të dhënash personale e sensitive, me fokus verifikimin e masave tekniko-organizative në garantimin e një procesi përpunimi të sigurt.

- Ka miratuar një rekomandim unifikues për 15 kontrollues publikë në sektorin e shëndetësisë për marrjen e masave tekniko-organizative, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave gjatë proceseve përpunuese.

- Ka vijuar angazhimin në veprimtari ndërgjegjësuese, sipas fushave të përgjegjësisë me autoritete publike, shoqërinë civile, medien dhe grupet e interesit për respektimin e të drejtave të qytetarëve.

- Ka luajtur rol aktiv në marrëdhëniet ndërkombëtare në kuadër të organizmave ku është anëtar, duke synuar zbatimin e praktikave më të mira në të dyja fushat e veprimtarisë.

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Zyra e Komisionerit për vitin 2022, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të anga-zhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të përmbyllë hetimin administrativ për publikimin e databazës me të dhënat e pagave të qytetarëve të punësuar në sektorin publik dhe privat, si dhe databazës me të dhënat e targave të automjeteve brenda vitit 2022.

2. Të luajë rol aktiv në përmbylljen e procedurave për modernizimin e kuadrit ligjor.

3. Të vijojë monitorimin dhe mbikëqyrjen proaktive të autoriteteve publike për verifikimin e përditësimit të Programit të Transparencës dhe të Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, me qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në veprimtarinë e tyre.

4. Të mbështesë autoritetet publike në qartësimin e çështjeve mbi interesin publik dhe rastet e kufizimit të dhënies së informacionit, si dhe të nxisë forcimin e rolit të koordinatorit për të drejtën e informimit.

5. Të vijojë shtrirjen e instalimit të sistemeve elektronike AMS dhe REKPDI në sa më shumë autoritete publike.

6. Të monitorojë dhe mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale me fokus masat tekniko-organizative për përpunimin e sigurt të tyre, veçanërisht Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI), duke u shtrirë edhe në sektorë të tjerë si ai i sigurimeve, financiar jobankar, marketing i drejtpërdrejtë etj.

7. Të angazhohet në monitorimin e vazhdueshëm për zbatimin e masave të lëna në rekomandimet e mëparshme për kontrollues publik e privat.

8. Të angazhohet në krijimin e rrjetit të nëpunësve për mbrojtjen e të dhënave personale, diktuar nga përmirësimi i legjislacionit kombëtar të kësaj fushe.

9. Të sigurojë pjesëmarrje aktive në cilësinë e anëtarit të Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) dhe vijimin e angazhimit aktiv në organizmat e tjerë ndërkombëtarë ku Zyra e Komisionerit është pjesë.

10.Të angazhohet në bashkëpunimin me qytetarë dhe grupe interesi për njohjen e kuadrit të modernizuar ligjor në të dyja fushat e përgjegjësisë dhe rritjen e ndërgjegjësimit për zbatimin e tij.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 28.4.2022.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI PËR VITIN 2021

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke vlerësuar rolin e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në grumbullimin, administrimin, ruajtjen dhe dokumentimin e materialeve të kësaj periudhe në Shqipëri;

- Duke njohur bashkëpunimin e këtij Instituti me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera vendëse e të huaja për shkëmbimin e informacionit e të përvojës lidhur me objektin e punës së Institutit;

- Duke konsideruar se detyrat kryesore të punës së këtij Instituti kërkojnë mbështetjen e vazhdueshme të organeve shtetërore, medies, shoqërisë civile dhe partnerëve, në funksion të ruajtjes së kujtesës tonë kolektive;

Shqyrtoi veprimtarinë e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit për vitin 2021 dhe konstaton, se:

- Ka arritur të kryejë studimin e çështjeve ekonomike gjatë regjimit komunist.

- Është angazhuar në aplikimin e formave inovative të pasqyrimit të veprimtarisë së Institutit.

- Ka shtuar numrin e botimeve të reja nga transkriptimi i arkivit audio-vizual të ISKK-së.

- Është angazhuar në rritjen e veprimtarisë në sektorin e edukimit shkollor me gjetjen e formave interaktive të përcjelljes së historisë së komunizmit, si dhe trajnimin e mësuesve për mënyrën e informimit mbi komunizmin.

- Është investuar në përdorimin e dëshmive audio-vizuale, si mjet i fuqishëm në rritjen e eficiencës së komunikimit përmes konkretizimit dhe memorizimit të historisë.

- Ka zhvilluar aktivitetin institucional në njohjen e të rinjve dhe informimin e publikut të gjerë me aspekte ideologjike të arkitekturës në komunizëm.

Kuvendi kërkon që Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit për vitin 2022, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të rinovojë marrëveshjen me ministrinë përgjegjëse për arsimin, me qëllim rritjen e aksesit në sektorin e edukimit shkollor të informacionit për krimet e komunizmit dhe të pasojave të tij në Shqipëri.

2. Të krijojë një bazë të dhënash të viktimave të burgjeve dhe kampeve me të dhënat që ISKK-ja disponon dhe të investohet në pasurimin e saj në mënyrë periodike.

3. Të angazhohet për zhvillimin e aktiviteteve në kuadër të edukimit qytetar, me fokus kryesor angazhimin e të rinjve, duke përdorur forma inovative të informimit për krimet dhe pasojat e komunizmit në vendin tonë, përfshirë edhe mjetet e teknologjisë së informacionit.

4. Të intensifikojë bashkëpunimin me universitetet përmes ofrimit të trajnimeve për studentët në kuadër të praktikës profesionale mbi katalogimin arkivor, si objektiv i parashikuar në Planin Strategjik 2022–2025 të ISKK-së.

5. Të zgjerojë bashkëpunimin me shoqatat vendëse dhe të diasporës, me qëllim mbledhjen e dëshmive që janë jashtë kufijve, si një burim potencial për zgjerimin e arkivit audio-vizuale apo kolanës së botimeve.

6. Në funksion të transparencës dhe informimit, të publikojë në faqen zyrtare procedurën e rekrutimit të Këshillit Shkencor dhe vendimmarrjet e këtij Këshilli.

7. Bordi i ISKK-së të angazhohet në zbatimin e Kodit të Etikës së institucionit për të siguruar paanësinë në ushtrimin e funksionit të anëtarëve të tij, si të zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë, dhe parandalimin e rasteve të papajtueshmërisë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 28.4.2022.

DEKRET
Nr. 13597, datë 29.4.2022

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 9 e 20, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Fana Rama Rugova
2. Teuta Ibrahim Rugova
3. Mendim Ibrahim Rugova
4. Ukë Ibrahim Rugova
5. Blerta Ali Rugova (Kllokoqi)
6. Blerina Ali Rugova (Kllokoqi)
7. Avdullah Halim Hoti
8. Servet Liman Hoti (Ukaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 282, datë 29.4.2022

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. MARK MARKU

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 43, datë 19.1.2022, të Këshillit të Ministrave, 'Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2022"', me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Mark Marku në masën 1 014 000 (një milion e katërmbëdhjetë mijë) lekë.
2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

UDHËZIM
Nr. 9, datë 27.4.2022

PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE AFATET PËR SHPALLJEN E THIRRJES DHE PËR DOKUMENTACIONIN E NEVOJSHËM PËR APLIKIM NGA NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE, PËR FINANCIMIN/ BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTEVE PËR PËRMIRËSIMIN E INFRASTRUKTURËS SHKOLLORE]DHE SPORTIVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar dhe të nenit 15, të ligjit nr. 115, datë 25.11.2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) shpall thirrjen për aplikim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV), për financimin/bashkëfinancimin e projekteve të reja të infrastrukturës shkollore dhe sportive, pas miratimit të buxhetit vjetor të detajuar.

2. Thirrja për aplikim nga NJVV-të, përmban:

a) drejtimet e thirrjes për financim;

b) afatet dhe formatin e aplikimit;

c) vlerën totale të financimit të projekteve dhe kohëzgjatjen e financimit;

d) vlerën e bashkëfinancimit nga NJVV për çdo projekt të aplikuar.

3. Afatet, formati, kriteret dhe dokumentacioni i aplikimit, si dhe vlera dysheme e bashkëfinancimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV) përcaktohen në shtojcat I, II, III dhe IV bashkëlidhur këtij udhëzimi, si dhe në thirrjen e shpallur për aplikim. Shpallja e thirrjes për aplikim publikohet në *website*-n e MAS-it, si dhe në Agjencinë e Prokurimit Publik.

4. Aplikimi kryhet nga NJVV-të pranë MAS-it, brenda afatit të përcaktuar në thirrjen e shpallur dhe kundrejt depozitimit të kërkesës zyrtare dhe dokumentacionit shoqërues të kërkuar.

5. Procedura e vlerësimit të projekteve të paraqitura nga NJVV-të kryhet nga Komisioni i ngritur nga ministri i Arsimit dhe Sportit, sipas kritereve të dhëna në shtojcën IV, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe metodologjisë së hartuar nga Komisioni, e cila miratohet me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

6. Të gjitha projektet e aplikuara do të renditen me pikë, bazuar në vlerësimin e kryer nga Komisioni. Numri i projekteve që financohen do të varet nga fondi në dispozicion, numri i projekteve të aplikuara, përmbushja e kritereve të aplikimit nga NJVV-të, si dhe niveli i bashkëfinancimit nga NJVV-të. Në thirrjen e shpallur përcaktohet niveli përkatës i bashkëfinancimit, në varësi me numrin e popullsisë së NJVV-ve.

7. Financimi i projekteve të infrastrukturës shkollore dhe sportive do të kryhet në dy vite buxhetore. Financimi për projektet fituese në vitin e parë është jo më pak se 20% e vlerës së plotë të projektit.

8. Në të gjitha rastet, kur në shpalljen e thirrjes për aplikim parashikohet bashkëfinancim i projektit, NJVV-ja duhet të paraqesë në aplikim edhe konfirmimin zyrtar, të miratuar nga organi kolegjial i NJVV-së, i përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, për marrjen përsipër të pjesës takuese të bashkëfinancimit. Aplikimi nuk i nënshtrohet procesit të shqyrtimit, në rast të mungesës së këtij dokumenti.

9. Kur projekti i miratuar nga MAS-i është rikonstruksion, NJVV-ja kryen verifikimin dhe merr konfirmimin nga Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM) ose Shërbimi Gjeologjik Shqiptar për gjendjen e tokës, si dhe oponencën teknike të projektit nga Universiteti Politeknik i Tiranës ose Instituti i Ndërtimit për projektin teknik, si në rastet e objekteve për rikonstruksion ashtu edhe për ndërtimet e reja.

10. NJVV-të, në aplikimin e projekteve për ndërtime të reja të institucioneve arsimore apo zgjerimin e atyre ekzistuese, duhet të paraqesin projekte sipas përcaktimeve të vendimit nr. 319, datë 12.4.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave", të ndryshuar.

11. NJVV-ja dhe/ose MAS-i, merr konfirmim paraprak nga zyrat arsimore vendore parauniversitare lidhur me nevojën për ndërtimin e objekteve të reja, rehabilitimin e atyre ekzistuese apo mundësive për përqendrimin ose racionalizimin e institucioneve arsimore. Në rast të mosparaqitjes apo moskonfirmimit nga zyra arsimore përkatëse, aplikimi nuk i nënshtrohet fazës së vlerësimit.

12. Projektet shpallen fituese me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe njoftimi i fituesve publikohet në *website*-in e MAS-it. NJVV-të njoftohen zyrtarisht për financimin e përfituar, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar.

13. Për vlerësimin e projekteve ngarkohet Komisioni për vlerësimin e projekteve. Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MAS ngarkohen edhe për administrimin e aplikimeve, njoftimet e NJVV-ve dhe detajimin e fondeve buxhetore, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

14. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Komisioni për Vlerësimin e Projekteve dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT

Evis Kushi

SHTOJCA I
VLERA MINIMALE E
BASHKËFINANCIMIT PËR ÇDO PROJEKT

Niveli dysheme i vlerës së bashkëfinancimit për çdo projekt të jetë, si më poshtë vijon:

a) Për njësitë e vetëqeverisjes vendore me popullsi nën 50 000 (pesëdhjetë mijë) banorë, vlera dysheme e bashkëfinancimit nga ana e njësisë së vetëqeverisjes vendore të jetë në masën jo më pak se 15% të vlerës së plotë të projektit, alokuar për vitin korrent ose i përpjesëtuar për vitin pasues (nëse projekti zbatohet në dy vjet);

b) Për njësitë e vetëqeverisjes vendore me popullsi mbi 50 000 (pesëdhjetë mijë) banorë, vlera dysheme e bashkëfinancimit nga ana e njësisë së vetëqeverisjes vendore, të jetë në masën jo më pak se 20% të vlerës së plotë të projektit, nga të cilat alokuar 10% për vitin korrent dhe diferenca për vitin pasues (nëse projekti zbatohet në dy vjet);

c) Për njësitë e vetëqeverisjes vendore me popullsi mbi 100 000 (njëqind mijë) banorë, vlera dysheme e bashkëfinancimit nga ana e njësisë së vetëqeverisjes vendore, të jetë në masën jo më pak se 25% të vlerës së plotë të projektit, nga të cilat alokuar 15% për vitin korrent dhe diferenca për vitin pasues (nëse projekti zbatohet në dy vjet).

Diferenca mes vlerës së projektit me vlerën e kontratës, nëse ka një të tillë, pas prokurimit publik do ti zbritet financimit me burim fondet e MAS pjesë e fondeve për financimin e infrastrukturës shkollore.

Në shpalljen e thirrjes për aplikim, MAS-i përcakton vlerën specifike të bashkëfinancimit, në nivelin jo më pak se niveli dysheme i përcaktuar në udhëzim.

SHËNIM

Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) bazuar edhe në të dhënat nga INSTAT-i, i referohet të dhënave të Ministrisë së Brendshme (sipas të dhënave të vitit të fundit) për numrin e popullsisë së njësive të vetëqeverisjes vendore, me mbi dhe nën 50 000 (pesëdhjetë mijë) banorë, për t'u referuar pranë Komisionit për vlerësimin e projekteve në MAS.

SHTOJCA II
KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Botimi në web e MAS-it dhe Agjencinë e Prokurimit Publik (APP)	Ministria e Arsimit dhe Sportit.	Hapja e thirrjes për projekte të reja sipas drejtimeve të thirrjes, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij udhëzimi.
Ditë kalendarike nga botimi në web e MAS-it ose Agjencinë e Prokurimit Publik APP (afati përcaktohet në shpalljen e thirrjes)	Aplikuesit sipas pikës 3, të këtij udhëzimi/NJVV-të.	Dërgimi i aplikimeve nga aplikuesit, si më poshtë vijon: 1. Aplikimi me shkresë zyrtare (postë ose protokollim dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit (në format *hard copy,* si dhe CD) dërgohet pranë komisioni teknik, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.
Ditë kalendarike nga mbyllja e aplikimit (afati përcaktohet në shpalljen e thirrjes)	Komisioni për vlerësimin e projekteve	Vlerësimi i projekteve të aplikuara sipas shtojcës III të këtij vendimi.
	Komisioni për vlerësimin e projekteve	Komisioni paraqet zyrtarisht pranë ministrit të Arsimit dhe Sportit listën e projekteve që propozohen për financim.

SHTOJCA III
FORMATI I APLIKIMIT PËR PROJEKTET

Ky format plotësohet për të gjitha projektet.

Aplikuesi (*)	NJVV-të respektive
Data e aplikimit (*)	Përcaktohet nga NJVV-të.
Titulli i projektit (*)	Titulli i projektit të jetë i njëjtë me titullin që specifikohet në kërkesën e depozituar pranë komisionit në MAS.
Programi i projektit (*)	Të përcaktohet për cilën drejtim të thirrjes aplikohet (sipas drejtimit të thirrjes së shpallur nga MAS-i).
Data e fillimit të projektit (*)	Të paraqitet grafiku i prokurimit dhe grafiku i zbatimit të punimeve të projektit, për të qartësuar shtrirjen kohore të tij.
Data e mbarimit të projektit (*)	Të jepet data kur parashikohet të përfundojë projekti
Përshkrimi i projektit (*)	Të bëhet përshkrim i detajuar i projektit të propozuar, duke përmbajtur informacionin e mëposhtëm, por jo vetëm: - Vendndodhja e objektit të investimit: specifikuar në hartë ku është sqaruar qartë kufiri i ndërhyrjes; - Përshkrimi i kushteve të objektit ekzistues (nëse ka) dhe terrenit, si dhe nevojës për këtë projekt; - Përshkrimi i detajuar i punimeve/ndërhyrjeve që do të kryhen; - Standardi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, në projektim; - Grafiku i prokurimit dhe grafiku i zbatimit të punimeve; - Cilat janë problemet që adreson ky projekt dhe shkalla e ndikimit të tij; - Për shkollat në fshatrat dhe/ose njësitë e vetëqeverisjes vendore nën 50 000 (pesëdhjetë mijë) banorë, aplikuesi paraqet informacion për numrin aktual dhe të pritshëm të nxënësve të shkollës, për të cilat kërkohet bashkëfinancimi, si dhe për shkollat dhe numrin e nxënësve në shkollat që gjenden në një distancë prej 4–5 km nga shkolla që kërkohet bashkëfinancimi, me qëllim optimizimin e mundësisë së investimit, përmes grupimit; - Risqet për zbatimin e tij; - Informacion i qartë në lidhje me pronësinë e tokës (nëse aplikohet), si edhe dokumentacioni përkatës (harta përkatëse kadastrale etj.).
Qëllimi dhe objektivat (*)	Të paraqitet qëllimi i përgjithshëm i projektit, si dhe objektivat specifikë të tij.
Numri i përfituesve (*)	Të jepet numri i popullsisë (nxënës/mësues/komunitet) që përfitojnë drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga zbatimi i projektit. Vlera e dhënë të shoqërohet me shpjegim për secilën kategori përfituesish.
Sipërfaqe e trajtuar (*)	Të specifikohet sa është sipërfaqja e përgjithshme në të cilën ndërhyn projekti dhe nëse zhvillohet me faza apo lote.
Rendi prioritar (*)	Në rastet e aplikimit të më shumë se 1 (një) projekti për të njëjtin program, renditini projektet sipas prioritetit/nevojës për ndërhyrje/lidhjes me drejtimet e thirrjes (numri 1 për shumë prioritar, numri 2 për më pak prioritar, e kështu me radhë).
Qëndrueshmëria e projektit (*)	Të përshkruhet në mënyrë analitike, nëse aplikuesi do të ketë nga ky projekt: - kostoja për mirëmbajtjen e projektit, pas zbatimit të tij; - nëse po, specifikoni sa parashikohen, si do të sigurohen etj.; - të specifikohet periudha në vite për kostot e mirëmbajtjes.
Fondet e kërkuara nga MAS-i (*)	Në rast se projekti nuk ka financim nga donatorë, kostoja/fondi që kërkohet është e barabartë me koston totale të projektit (në çdo rast, vlera të jetë me TVSH) minus vlerën dysheme të detyrueshme të bashkëfinancimit nga njësia e vetëqeverisjes vendore, sipas shtojcës I të këtij udhëzimi.

Kontributi i detyrueshëm në bashkëfinancim nga njësia e vetëqeverisjes vendore (*)	Aplikuesi e shoqëron aplikimin me një shkresë zyrtare, të nënshkruar nga kryetari i Bashkisë ose kryetari i Këshillit Bashkiak, ku merr përsipër së paku vlerën dysheme të bashkëfinancimit për këtë aplikim, të përcaktuar në shtojcën I të këtij udhëzimi. Aplikuesi mund të bashkëfinancojë një vlerë me të madhe se sa vlera dysheme, nëse e shikon të mundur. Marrja përsipër e bashkëfinancimit nga aplikuesi, në, minimumi, vlerën dysheme të tij të përcaktuar në shtojcën I, të këtij udhëzimi dhe paraqitja e shkresës që e konfirmon këtë është kusht detyrues për kalimin në fazën e vlerësimit të aplikimit dhe për (potencialisht) miratimin e financimit.
Financim nga donatorë (*)	Nëse ka financim nga donatorë, të jepet vlera e pritshme e donacionit në monedhën lek.
Financime të tjera	Nëse ka burime të tjera financimi, të jepet vlera e financimit në monedhën lekë.
Kostoja totale e projektit (*)	Kostoja totale e projektit të jepet me TVSH.
Projekti ka një analizë kosto-përfitim të cilësisë së mirë (opsionale)	☐ Po / ☐ Jo
Përmbledhje e analizës kosto-përfitim	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e analizës kosto-përfitim, nëse ka një të tillë.
Projekti ka një vlerësim të ndikimit në mjedis të cilësisë së mirë (opsionale)	☐ Po / ☐ Jo
Përmbledhje e vlerësimit të ndikimit në mjedis	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e vlerësimit të ndikimit në mjedis, nëse ka një të tillë.
Deklarime (*)	Aplikuesi deklaron se: i. projekti është gati për zbatim (pra, nëse i disponon të gjitha dokumentet që nevojiten për zbatimin e tij) dhe koha kur mund të fillojë dhe të përfundojë procedura e prokurimit publik dhe kur mund të fillojë dhe të përfundojë zbatimi i punimeve. ii. projekti është në listën e projekteve/nevojave të parashikuara nga institucioni përkatës, është pjesë e planeve vendore të zhvillimit dhe/ose të prioriteteve. iii. me miratimin e financimit, autoriteti kontraktues ka siguruar/do të sigurojë pajisjen me të gjitha lejimet e nevojshme për zbatimin e projektit, sipas legjislacionit të fuqi. iv. janë zbatuar çmimet e referencës dhe legjislacionit në fuqi për përllogaritjen e kostos dhe vlerës financiare të projektit.
Dokumentet teknike (*)	Të sqarohet nëse dosja e aplikimit përmban: - projektin teknik/projektin e zbatimit; - preventivin; - grafikun e prokurimit dhe grafikun e zbatimit të punimeve; - relacionin teknik; - specifikimet teknike; - CD; - përllogaritjet/parashikimin e kostove të mirëmbajtjes së investimit.
Foto – gjendja ekzistuese (*)	Imazhe në formatin .jpeg ose .pdf
Pamje 3-dimensionale (*) i detyrueshëm	Imazhe në formatin .jpeg ose .pdf

(*) Fushat që kanë * janë të detyrueshme për t'u plotësuar.

Shënim. Dërgimi i aplikimeve, sipas afatit:

1. Aplikimet për projekte duhet të dërgohen me shkresë zyrtare (postë ose protokollim dorazi), së bashku me dosjen e plotë të aplikimit në format *hard copy* dhe CD, pranë komisionit/ Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

2. Formati i aplikimit duhet të dorëzohet i firmosur dhe i vulosur nga institucioni/subjekti aplikues.

3. Dokumentacioni teknik i dorëzuar duhet të jetë detyrimisht i firmosur dhe i vulosur nga autorët përkatës.

4. Nëse aplikuesi nuk merr përsipër vlerën dysheme të bashkëfinancimit të përcaktuar, sipas shtojcës I të këtij vendimi, atëherë aplikimi nuk kalon në fazën e vlerësimit.

SHTOJCA IV
KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE QË PROPOZOHEN PËR FINANCIM/BASHKËFINANCIM

Këto kritere përdoren nga komisioni për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet **vlerësimi, maksimalisht me 100 pikë**, i një projekti që propozohet për financim/ bashkëfinancim.

Vlerësimi i projekteve kryhet nga komisioni për vlerësimin e projekteve bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim, si dhe në një metodologji të përcaktuar, e cila miratohet me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

Kriteret për vlerësimin e projekteve janë, si më poshtë vijon:

1. Shkalla e ndikimit në arritjen e objektivave të politikës dhe impakti në realizimin e masave, sipas drejtimeve të thirrjes: ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 15 pikë.**

2. Cilësia teknike dhe kostimi, vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ky kriter nënkupton se projektet që teknikisht janë detajuar saktë dhe qartë me grafik punimesh të detajuar, si dhe ato projekte, ku kostimi i tyre dhe preventivi janë përpiluar e vlerësuar saktë nga aplikuesi, me çmimet referencë sipas buletineve etj., do të vlerësohen si koherente për financim: ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 25 pikë.**

3. Ndikimi i projekteve dhe avantazhet në lehtësimin e aksesit në shërbimet arsimore, ndërveprimit midis zonave urbane e rurale, duke rritur mbulimin në shërbime, edhe përmes grupimit të shkollave me numër të vogël nxënësish, zgjidhjen e nevojës emergjente për ndërhyrje, përmirësimit të cilësisë së shërbimit dhe jetës komunitare dhe më gjerë, zhvillimin ekonomiko-social, parë nga ana e përfituesit, qytetarit: ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 25 pikë.**

4. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshkrimit të projektit, që orientojnë mbi riskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike: ky kriter vlerësohet me **0 deri në maksimalisht, 10 pikë.**

5. Numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë (nxënës/ mësues/komunitet) nga projekti ose zona kryesore dhe dytësore e ndikimit/mbulimit të shërbimit prej tij. Vlerësimi sipas këtij kriteri kryhet në varësi të numrit të institucioneve/përdoruesve/shërbimeve që përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë: ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 15 pikë.**

6. Niveli i bashkëfinancimit përmbi vlerën dysheme (minimale) të bashkëfinancimit, me fonde të tjera nga njësitë e vetëqeverisjes vendore apo me fondet e donatorëve: ky kriter vlerësohet me **0 deri në maksimalisht, 10 pikë.**

URDHËR
Nr. 244, datë 14.4.2022

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR TREGTIMIN ME SHUMICË APO PAKICË TË PAJISJEVE MJEKËSORE NËPËRMJET INTERNETIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 28 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe nenit 24, pika 3, të ligjit 89/2014, "Për pajisjet mjekësore", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Tregtimi me shumicë i pajisjeve mjekësore nëpërmjet internetit kryhet nga tregtuesit me shumicë, të cilët janë persona juridikë të licencuar, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet, dhe në zbatim të kritereve të vendosura në këtë urdhër.

2. Tregtimi me pakicë i pajisjeve mjekësore nëpërmjet internetit kryhet nga tregtuesit me pakicë, të cilët janë persona fizikë dhe juridikë të licencuar, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet, dhe në zbatim të kritereve të vendosura në këtë urdhër.

3. Lejohet tregtimi i pajisjeve mjekësore nëpërmjet internetit për përdoruesit joprofesionistë vetëm për klasën I dhe IIa dhe pajisjet mjekësore të destinuara për mbrojtje kundër përhapjes së sëmundjeve ngjitëse, nëse ato mund të përdoren në mënyrë të sigurt.

4. Lejohet tregtimi i pajisjeve mjekësore nëpërmjet internetit për të gjitha klasat vetëm për

përdoruesit profesionistë, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Të gjitha pajisjet mjekësore që do të tregtohen nëpërmjet internetit duhet të jenë të pajisura me markimin CE ose certifikimin FDA, si dhe duhet të jenë të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi.

6. Faqja e internetit duhet të jetë një strukturë e licencuar nga organi përgjegjës AKEP-i dhe të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

a) të dhëna të plota mbi adresën dhe identitetin ligjor të shitësit;

b) objektin e veprimtarisë "tregtim me shumicë apo pakicë të pajisjeve mjekësore";

c) listën e pajisjeve mjekësore;

d) fotografi të pajisjes, përshkrimin e pajisjes dhe udhëzime mbi përdorimin e pajisjes.

7. Tregtuesit me shumicë apo pakicë të pajisjeve mjekësore, para fillimit të tregtimit të pajisjeve mjekësore nëpërmjet internetit, duhet të njoftojnë Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore nëpërmjet postës elektronike, në adresën: akpbm@shendetesia.gov.al. Njoftimi duhet të përmbajë informacionin, si vijon:

a) Listën e pajisjeve mjekësore që do të tregtohen nëpërmjet internetit, me të dhënat si vijon:

i. modelin e pajisjes;

ii. prodhuesin;

iii. numrin e certifikatës së regjistrimit.

b) Faqen e internetit që subjekti do të përdorë për tregtimin e pajisjeve mjekësore të certifikuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.

c) Emrin dhe adresën e ambienteve për magazinim dhe për ruajtje të pajisjeve mjekësore të regjistruar në QKB dhe të licencuar nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë.

8. Pajisjet mjekësore që do të tregtohen nëpërmjet internetit duhet të jenë të etiketuara dhe pajisura me fletudhëzuesin e përdorimit në gjuhën shqipe. Ky informacion duhet të jetë gjithmonë i disponueshëm dhe lehtësisht i aksesueshëm në platformën elektronike ku kryhen veprimet e marketimit dhe të shitblerjes së pajisjes mjekësore.

9. Tregtuesi me shumicë apo me pakicë i pajisjeve mjekësore duhet të tregtojë pajisjet mjekësore vetëm në paketimin origjinal të prodhuesit.

10. Tregtuesi me shumicë apo me pakicë i pajisjeve mjekësore duhet të ruajë në një regjistër të veçantë të gjitha shitjet e pajisjeve mjekësore të kryera nëpërmjet internetit. Regjistri i shitjeve të pajisjeve mjekësore të kryera nëpërmjet internetit është subjekt kontrolli nga institucionet përgjegjëse për inspektim, sipas legjislacionit në fuqi.

11. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri struktura përgjegjëse për pajisjet mjekësore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe subjektet që do të ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit me shumicë apo me pakicë të pajisjeve mjekësore nëpërmjet internetit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 154/1, datë 29.4.2022

PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE NË SHPENDË, NË MJEDISET E HAPURA DHE NË TREGJET E KAFSHËVE TË GJALLA

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës; të shkronjës "b", nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e shitjes dhe të tregtimit të shpendëve të gjallë në mjediset e hapura dhe tregjet e kafshëve të gjalla, në bashkitë Lushnjë, Divjakë, Shkodër, Shijak dhe Durrës.

2. Ndalimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë nga ferma në fermë dhe nga ferma në tregjet e kafshëve të gjalla, në bashkitë Lushnjë, Divjakë, Shkodër, Shijak dhe Durrës.

3. Lejimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë, vetëm për në thertore, në bashkitë Lushnjë, Divjakë, Shkodër, Shijak dhe Durrës, të shoqëruar

me dokumentacionin e parashikuar, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Urdhri nr. 154, datë 1.4.2022, "Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla", shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

URDHËR
Nr. 272, datë 26.4.2022

PËR SHFUQIZIMIN E URDHRIT NR. 374, DATË 30.8.2021, "PËR HYRJEN E PERSONAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NGA TË GJITHA PIKAT KUFITARE"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 113 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri nr. 986/3 prot., datë 26.4.2022,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 374, datë 30.8.2021, "Për hyrjen e personave në Republikën e Shqipërisë nga të gjitha pikat kufitare".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë, i fillon efektet më datë 1.5.2022 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 273, datë 26.4.2022

PËR SHFUQIZIMIN E URDHRIT NR. 351, DATË 29.5.2020, "PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA DHE KUFIZIMEVE PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË COVID-19", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e përhapur nga Coronavirusi i ri nr. 986/3 prot., datë 26.4.2022,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 351, datë 29.5.2020, "Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së COVID-19", të ndryshuar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë, dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

VENDIM
Nr. 104, datë 6.4.2022

AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE "NDIHMË ME KARAKTER SOCIAL PËR PASAGJERËT NË FLUTURIMET AJRORE"

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- znj. Delina Ibrahimaj kryetare;
- znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- znj. Etleva Haka anëtare;
- znj. Mirjana Zisi anëtare;
- z. Ahmet Mançellari Anëtar,

në mbledhjen e tij të radhës të datës 6.4.2022, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën

shtetërore", të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, "Për miratimin e rregullores 'Për procedurat dhe formën e njoftimit'", morri në shqyrtim planin e dhënies së ndihmës shtetërore me karakter social për pasagjerët në fluturimet ajrore.

I. Procedura

1. Në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, Komisioni i Ndihmës Shtetërore shqyrtoi planin e ndihmës, lidhur me ndryshimin e udhëzimit nr. 1917, datë 1.9.2014, "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë".

II. Përshkrimi i masës

2. *Qëllimi:* Rritja e numrit të pasagjerëve që udhëtojnë nga dhe drejt Shqipërisë. Plani i ndihmës lidhet me një eliminim të tarifës së shërbimit, për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë, në vlerën 10 euro, i cili aktualisht paguhet nga udhëtari në momentin e blerjes së biletës, te shoqëritë ajrore, pavarësisht vendit apo mënyrës së shitjes së biletës.

3. *Baza ligjore e njoftimit të planit:* Plani i ndihmës shtetërore lidhet me rishikimin e udhëzimit nr. 1917, datë 1.9.2014, "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë".

4. *Dhënësi i ndihmës* është Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

5. Autoriteti përgjegjës për monitorimin e zbatimit të masës është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

6. *Përfituesit:* Përfitues janë konsumatorët/ pasagjerët e transportit ajror. Sipas MIE-s, nga skema pritet të përfitojnë rreth 4 milionë pasagjerë në vitin 2022, për të cilët do të zbatohet përjashtimi nga tarifa e shërbimit.

7. *Shtrirja territoriale:* Projekti do të zbatohet në territorin e Shqipërisë.

8. *Forma e ndihmës:* Ndihma shtetërore është në formën e eliminimit të detyrimit nga ana e shoqërive ajrore të përgjegjësisë që të arkëtojnë nëpërmjet shitjes së biletës tarifën e kalimit me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë dhe të transferimit të shumave të arkëtuara tek TIA.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

9. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson, nëse plani i ndihmës shtetërore me karakter social për pasagjerët në fluturimet ajrore përbën ndihmë shtetërore, në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, pra, nëse plani ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje, të cilat kanë një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe tregtinë midis shteteve anëtare, që nuk do të ishte përfituar në kushte normale të tregut.

10. Neni 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, përcakton se:

"Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore."

11. Gjithashtu, neni 71, "Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike", i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë[1], përcakton se:

"Praktikat në kundërshtim me këtë nen, vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës së aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit Themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit."

12. Ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, konkretisht: a) burime shtetërore; b) avantazhi ekonomik; c) selektiviteti; dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

13. Vendimi për të eliminuar tarifën e shërbimit, për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë, në vlerën 10 euro, përbën një aktivizim të burimeve shtetërore. Eliminimi i tarifës favorizon dhe lehtëson funksionimin e shërbimeve ajrore midis Shqipërisë dhe vendeve të huaja, duke

[1] Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, "Për ratifikimin e 'Marrëveshjes së stabilizim-asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare'".

gjeneruar një kërkesë shtesë për bileta të fluturimit me avion dhe në mënyrë indirekte do të përfitojnë të gjitha kompanitë që ofrojnë shërbime të transportit ajror në tregun vendës. Kërkesa në rritje për numrin e fluturimeve do të ndikojë në tregtinë ndërkombëtare, pra masa ka efekt të kufizuar në konkurrencë, duke qenë se favorizon kompanitë që ofrojnë shërbime të transportit ajror drejt dhe nga Shqipëria. Sipas Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar rezulton se vetëm në vendin tonë aplikohet tarifa e shërbimit për kalimin me avion të kufirit, në raport me vendet e rajonit, por edhe llojeve të tjera të transportit, të përmbledhur në tabelën nr. 1, si vijon:

Tabela nr. 1: *Tarifat e aplikuara në rajon*

Tarifat	Tirana	Shkup	Beograd	Sarajevë	Dubrovnik	Podgoricë	Prishtina	Lubjana
Tarifa e sigurisë	4	6.5	4.5	0	5	1.75	6	4.6
Tarifa e pasagjerit	10	11.5	16.5	18	11	15	12.53	10
Tarifa e kalimit të kufirit me avion	10	0	0	0	0	0	0	0
TOTALI	24	18	21	18	16	16.75	18.53	14.6

Burimi: Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar

Sipas Asamblesë së Rajoneve Evropiane[2], konektiviteti është i rëndësishëm për rritjen ekonomike dhe krijimit të vendeve të reja të punës në Bashkimin Evropian. Në një kohë kur Evropa po hap tregjet globale, aeroportet rajonale luajnë një rol në zhvillimin ekonomik, duke ofruar akses më të madh, përmirësim të kohezionit dhe zhvillimin social, si dhe rritjen e konkurrueshmërisë në Evropë. Komisioni Evropian vlerëson se transporti dhe infrastruktura e tij janë thelbësore për zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e shoqërisë. Rajonet përfitojnë nga operimi i linjave ajrore të ofruara nga operimi i aeroporteve të tyre. Lidhjet ajrore krijojnë akses rajonal dhe përfshirjen sociale, përmirësojnë pozicionimin e biznesit në atë zonë, lehtësojnë tregtinë dhe, në veçanti, mundësojnë tërheqjen e investimeve. Aeroportet rajonale përmirësojnë klimën lokale të biznesit dhe mundësitë për zhvillimin ekonomik.

Një nivel aksesi i mirë në transportin ajror, mundëson krijimin e përfitimeve për tërheqjen e kompanive dhe të punëtorëve me kualifikim të lartë. Aksesueshmëria e një rajoni përcaktohet nga dy faktorë: vendndodhja gjeografike dhe infrastruktura. Ndërsa vendndodhja gjeografike nuk mund të ndryshohet, përmirësimi i konektivitetit është një objektiv kryesor.

Sipas të dhënave të INSTAT-it:

- Në Shqipëri, hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin shkurt 2022 janë 458.951 dhe, se krahasuar me shkurtin 2021, ky tregues rezulton me një rritje 27,3 %. Në shkurt 2022, numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 200.997 dhe e krahasuar me shkurtin 2021, ky numër është rritur me 27,1%. Ndërkohë, numri i shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri gjatë vitit 2021 është 5.688.649, **duke u rritur me 2,1 herë**, në krahasim me vitin 2020. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga Shqipëria në vitin 2021, është 4.190.786, **duke u rritur 44,2 %**, krahasuar me vitin e mëparshëm.

- Sipas INSTAT-it, referuar të dhënave mbi hyrjet e shtetasve të huaj në Shqipëri, sipas qëllimit të udhëtimit, 2014–2021, rezulton se mesatarisht 98.23% e të huajve vizitojnë Shqipërinë për arsye personale (pushime etj.).

- Sipas të dhënave nga Banka e Shqipërisë, shpenzimet nga turistët e huaj, në periudhën 2015–2019 kanë një rritje të ndjeshme në vlerë absolute, por edhe në raport me PBB-në, ku në vitin 2019 shpenzimet e turistëve të huaj **përbëjnë 15.1**%. Ndërkohë, në vitin 2021, ecuria e shpenzimeve është pozitive krahasuar me vitin 2020 (vit i pandemisë së COVID-19), duke **u rritur në 12.4%** të PBB-së.

Sipas Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë raportohet, se gjatë vitit 2019, numri i uljeve dhe i ngritjeve në Aeroportin "Nënë Tereza" ka qenë 28,270 fluturime dhe gjatë vitit 2021 ishin 26,152 fluturime. Fillimi i vitit 2022 rezulton me një rritje të trafikut, duke tejkaluar numrin e fluturimeve për të njëjtën periudhë të vitit 2019. Gjatë vitit 2022 pritet që rritja e trafikut të fluturimeve të jetë rreth 12%.

[2] Shtator 2013.

Sipas MIE-s, në vitin 2021, në Shqipëri ka 19 operatorë ajrorë, kundrejt vitit 2019, në të cilin kanë ushtruar aktivitetin 17 operatorë ajrorë. Sipas MIE-s, heqja e tarifës aktuale, do të ketë një impakt domethënës në uljen e çmimit të biletave, duke ndikuar pozitivisht tek operatorët për të rritur numrit e destinacioneve të fluturimeve nga aeroporti, në përputhje me objektivat e Strategjisë së Aviacionit Civil. Gjatë vitit 2019 në aeroportin e TIA-s janë regjistruar rreth 3,338,147 pasagjerë, ndërkohë që në vitin 2021 ky numër arriti në 2,923,533 pasagjerë. Vlerësohet se ulja e çmimit të biletave, si pasojë e heqjes së tarifës aktuale, do të rrisë edhe më shumë aksesin në aviacion dhe parashikimi i pasagjerëve, vetëm gjatë 2022, pritet të arrijë në 4 milionë pasagjerë. Heqja e kësaj tarife do të ketë një impakt të drejtpërdrejtë në rritjen e trafikut ajror, numrit të linjave ajrore, destinacioneve të reja dhe numrit të pasagjerëve edhe në infrastrukturat e reja aeroportuale, siç është Aeroporti Ndërkombëtar i Kukësit dhe Aeroporti Ndërkombëtar i Vlorës.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se plani i njoftuar është ndihmë shtetërore.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

14. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson se masa lidhet me një "ndihmë me karakter social, që iu jepet konsumatorëve individualë" dhe, për këtë arsye, është në përputhje me dispozitat e shkronjës "a", të nenit 7, të ligjit nr. 9374, datë 25.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, i cili parashikon, se: "ndihma me karakter social, që jepet për individë, nëse kjo ndihmë është dhënë pa krijuar diskriminim lidhur me origjinën e produkteve në fjalë", është një ndihmë shtetërore e lejueshme.

15. Komisioni konstaton se eliminimi i tarifës është në dobi të konsumatorëve fundorë/ pasagjerët e transportit ajror. Heqja e tarifës pritet të ketë një impakt të drejtpërdrejtë në rritjen e trafikut ajror, numrin e linjave ajrore, destinacioneve të reja, numrin e pasagjerëve, si edhe në infrastrukturat e reja aeroportuale, si Aeroporti Ndërkombëtar i Kukësit dhe Aeroporti Ndërkombëtar i Vlorës. Kompanitë e transportit ajror aplikonin tarifën në çmimin e biletës së fluturimit të pasagjerit. Në këtë mënyrë, eliminimi i tarifës do t'u mundësojë pasagjerëve lirimin nga pagesa e kësaj tarife. Kompanitë ajrore duhet të tregojnë dukshëm çmimin e biletës, si edhe tarifat e detajuara. Pra, masa është e projektuar për t'i lejuar konsumatorët që të udhëtojnë në mënyrë ekonomike nga dhe drejt Shqipërisë.

16. Sipas studimeve të *Oxford*-it[3], përmirësimet në konektivitetin ajror ndikojnë në zhvillimin ekonomik, nëpërmjet rritjes së produktivitetit. Rritja e produktivitetit në bizneset jashtë industrisë së shërbimit të aviacionit është rrjedhojë e dy burimeve kryesore: rritjes së aksesit të biznesit vendës në tregjet e huaja dhe rritjes së konkurrueshmërisë së bizneseve të huaja në tregun vendës, si edhe nëpërmjet lëvizjes së lirë të kapitalit investues dhe fuqisë punëtore ndërmjet vendeve.

17. Sipas të dhënave nga Banka e Shqipërisë, shpenzimet nga turistët e huaj, në periudhën 2015–2019 kanë një rritje të ndjeshme në vlerë absolute, por edhe në raport me PBB-në, ku në vitin 2019 shpenzimet e turistëve të huaj përbëjnë 15.1%. Ndërkohë, në vitin 2021, ecuria e shpenzimeve është pozitive krahasuar me vitin 2020, për shkak të COVID-19, duke u rritur në 12.4% të PBB-së.

***Tabela 2**: Eksportet e shërbimeve të udhëtimit, si përafrues i treguesit për të ardhurat nga turistët e huaj (të dhëna që burojnë nga statistikat e bilancit të pagesave), të shprehura në milionë euro dhe si raport ndaj PBB-së*

Treguesit	**2015**	**2016**	**2017**	**2018**	**2019**	**2020**	**2021**
Exp, shërbime udhëtimi (milionë euro)	1352.4	1527.9	1707.6	1856.7	2083.3	988.2	1912.3
Raport ndaj PBB-së (%)	13.2	14.3	14.8	14.5	15.1	7.4	**12.4**

Burimi: Banka e Shqipërisë

[3] Oxford Economics, November 2014.

Sa më lart, Komisioni vlerëson, se plani i ndihmës shtetërore është i lejueshëm në përputhje me nenet 4 dhe 7, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 7, 17, 22 dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë skemën e ndihmës shtetërore nëpërmjet eliminimit të tarifës së shërbimit, për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë, të parashikuar në udhëzimin nr. 1917, datë 1.9.2014, "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë".

2. Ministria përgjegjëse për zhvillimin e transportit ajror, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për monitorimin e impaktit të ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar me informacion të detajuar mbi efektin e eliminimit të tarifës së shërbimit, për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë në çmimin e biletave për pasagjerët, rritjen e turistëve të huaj, të ardhurat shtesë në buxhetin e shtetit.

3. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

4. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Delina Ibrahimaj

KËRKESË

Shtetasi Sajmir Kaptelli kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, shpalljen të zhdukur të shtetasit Meleq Kaptelli, i datëlindjes 10.3.1926, me numër personal C60310004H.

KËRKUES
Sajmir Kaptelli

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2022 - Numri: 68
Datë: 2022/05/06 13:19:23
c46634f9-3152-4e3a-af0f-21153b40083e

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë